

KONTRATË SHITJE KUOTASH

Sot më datë 29.08.2021, në ambientet e shoqërisë "**DBH CONSTRUCTION**" SH.P.K me seli në Rrugën "Tom Plezha", Pallati Klensi, Shkalla 3, Ap.37, me adresë për komunikim elektronik: dbhconstruction@gmail.com, palët ranë dakort si më poshtë:

Pala Shitëse : z. **Bledar Sinanaj**, atësia Hetem, i datëlindjes 08.04.1984, lindur në Potom Skrapar (Shqipëri) dhe banues në rrugën Ismail Qemali, Ap. 43, Hp 78/2, Njësia administrative nr. 14 Tiranë, shtetas Shqiptar, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër personal I40408077I, në vijim për efekt të kësaj kontrate referuar si "Shitës".

Dhe

Pala Blerëse: z. Mensur Rushiti, atësia Byniamin, i datëlindjes 08.06.1980, lindur në Berat (Shqipëri) dhe banues në Tirane, rruga Stavri Themeli, kompleksi Shushica, H13, Ap 52, shtetas Shqiptar, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër personal I00608134J, në vijim për efekt të kësaj kontrate referuar si: "Blerës".

Pala Blerëse: z. Arsen Musai, i datëlindjes 04.06.1978, lindur në Berat dhe banues në Tiranë (Shqipëri), rruga Medar Shtylla, Nd. Pall 49, H. Shk 41, Ap. 9, Njësia Administrative Nr. 5, Njësia Bashkiake Nr. 5, 1019, Tiranë, shtetas Shqiptar, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër personal H80604156L, në vijim për efekt të kësaj kontrate referuar si "Blerës".

Në vijim e për efekt të kësaj kontrate, shitësi dhe blerësit do të referohen veçmas si palë/a dhe së bashku si palë/t.

KUSHTET PARAPRAKE

Shitësi është ortak dhe zotëron 1 (një) kuotë të barabarte me 70% të kapitalit themeltar të shoqërisë "**DBH CONSTRUCTION**" SH.P.K., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS M01403001D, seli në Rrugën "Tom Plezha", Pallati Klensi, Shkalla 3, Ap.37, në vijim referuar edhe si "**Shoqëria**" me përfasues ligor Z. Bledar Sinanaj.

Shitësi dëshiron ti shesë Blerësit Z. Arsen Musai 1(në) kuotë të barabartë me 33% të kapitalit themeltar të shoqërisë sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në vijim, i cili dëshiron dhe pranon të blejë nga shitësi 1(një) kuotë të barabartë me 33% të kapitalit themeltar të shoqërisë, sipas kushteve dhe afateve të mëposhtme.

Shitësi dëshiron ti shesë Blerësit Z. Mensur Rushiti 3% të kapitalit në zotërim të tij.

Palët deklarojnë dhe pranojnë shprehimisht se përpara nënshkrimit të kësaj kontrate të gjithë ortakët e shoqërisë janë njoftuar për shitjen e kuotës sipas dispozitave të statutit dhe kanë dhënë miratimin paraprak nëpërmjet vendimit nr. 8, datë 29.08.2021

Mëqe ekzistojne kushtet paraprake, Palët, pranojnë të lidhin këtë kontrate sipas kushteve të mëposhtme:

NENI 1 KUSHTET PARAPRAKE

Kushtet paraprake janë pjesë përbërëse dhe thelbësore të kësaj kontrate.

NENI 2

SHITJA E KUOTËS

Nëpërmjet kësaj kontrate, Shitësi bie dakort të shesë, transferojë dhe dorëzojë 1 (një) kuotë të barabartë me 33% të kapitalit themeltar që ai zotëron në shoqërinë "**DBH CONSTRUCTION**" **SH.P.K.**, tek Z. Arsen Musai dhe 3% të kapitalit në posedim të tij tek Z. Mensur Rushiti; të lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo çdo të drejtë në favor të të tretëve, në favor të Blerësve, të cilët pranojnë dhe blejnë sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë kontrate.

Shitja dhe transferimi i titullit të kuotës bëhet me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe dorëzimin e kuotës tek blerësit.

Blerësit marrin përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e shitës së dëshmorëve, si dhe merr përsipër detyrimet dhe pasivet e mundshme në proporcione pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e themeltar të shoqërisë.

Pas nënshkrimit të kësaj kontrate struktura e zotërimit të kapitalit të shoqërisë "**DBH CONSTRUCTION**" **SH.P.K.**, do të jetë:

- **Arsen Musai** bëhet ortak i shoqërisë, posedues i një (1) kuote të barabartë me 33 % të kapitalit të Shoqërisë me vlerë nominale 33,000 (tridhjetë e tre mijë) lekë.
- **Bledar Sinanaj**, është ortak i shoqërisë i cili bëhet posedues i një (1) kuote të barabartë me 34 % të kapitalit të Shoqërisë me vlerë nominale 34,000 (tridhjetë e katër mijë) lekë.
- **Mensur Rushiti**, është ortak i shoqërisë i cili bëhet posedues i një (1) kuote të barabartë me 33 % të kapitalit të Shoqërisë me vlerë nominale 33,000 (tridhjetë e tre mijë) lekë.

NENI 3

ÇMIMI

Çmimi i shitjes së kuotës për Z. Arsen Musai objekt i kësaj kontrate do të jetë në vlerën nominale 33.000 (tridhjetë e tre mijë) lekë të cilat janë të pakufizuar nga pala blerëse në favor të palës shitëse para nënshkrimit të kësaj kontrate sipas mandatit bashkëngjitur kësaj kontrate.

Çmimi i shitjes së 3% të kapitalit tek Z. Mensor Rushiti, objekt i kësaj kontrate do të jetë në vlerën nominale 3.000 (tre mijë) lekë të cilat janë të pakufizuar nga pala blerëse në favor të palës shitëse para nënshkrimit të kësaj kontrate sipas mandatit bashkëngjitur kësaj kontrate.

NENI 4

DEKLARIME DHE GARANCI TE SHITËSIT

Shitësi garanton blerësit se është personi i vetëm legitim për të marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e kësaj kontrate.

Shitësi garanton blerësit se kuota objekt i kësaj kontrate është e lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo çdo të drejte tjetër ë favor të të tretëve.

Blerësit deklarojnë se kanë dijeni për situatën ekonomiko-financiare, sipas gjendjes së faktit dhe të drejtës në të cilën ajo ndodhet në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate sipas dokumentave kontabël që shoqëria zotëron.

Shitësi me nënshkrimin e kësaj kontrate nuk ka dhe nuk do të ketë asnje pretendim në lidhje me kapitalin e transferuar nëpermjet shitjes objekt i kësaj kontrate.

NENI 5 SHPENZIME DHE TAKSA

Shpenzimet ligjore, taksat, shpenzimet notieriale, tarifat e regjistrimit në zyrat kompetente si dhe çdo shpenzim tjetër që lidhet me këtë kontratë do të jetë në ngarkim të blerësit.

Shpenzimet e tjera do të paguhen nga palët sipas legjislacionit në fuqi.

NENI 6 INTERPRETIMI I KONTRATËS

Kushtet e përcaktuara në këtë kontratë interpretohen pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve por duke pasur parasysh qëllimin e vërtetë të palëve, që i ka shtyrë për nënshkrimin e këtij akti. Kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit. Në rast dyshimi, kontrata ose kushtet e saja interpretohen në kuptimin në të cilin mund të kenë ndonjë efekt dhe jo në atë sipas të cilit nuk do të kishte ndonjë efekt.

Nëse pjesë të kësaj kontrate janë ose bëhen të pavlefshme ose jodetyruese, palët do të janë të detyruara të zbatojnë pjesën tjetër të kontratës. Në këtë rast palët do të zëvendësojnë pjesën e pavlefshme ose jo detyruese me parashikime të vlefshme e detyruese, efektet e të cilave sipas përbajtjes dhe qëllimeve të kësaj kontrate duhet të janë në kufijtë e të mundshmes e të ngashme në pjesën e pavlefshme ose jodetyruese.

NENI 7
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin, direkt ose indirekt midis palëve kontraktuese në lidhje me interpretimin, ekzekutimin, zgjidhen apo vlefshmërinë e kësaj kontrate palët paraprakisht duhet të diskutojnë në lidhje me këto mosmarrëveshje për zgjidhen e tyre me mirëkuptim. Nëse nuk arrihet një marrëveshje sipas parashikimeve të bëra në këte nen për zgjidhen e mosmarrëveshjeve kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë.

NENI 8
LIGJI I ZBATUESHËM

Kjo kontratë rregullohet nga legjislacioni shqiptar dhe shpreh vullnetin e palëve.

NENI 9
ANEKSET E KONTRATËS


Kësaj kontrate i bashkëngjiten si pjesë përbërëse dhe të pandara këto dokumenta që do të quhen anekse të kontratës. Anekse të kontratës jane:

- Ekstrakti i Regjistrat themeltar.
- Kopje të letërnjoftimit të personave nënshkrues.
- Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme.

Kjo kontratë hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje me vlerë të njëjtë nga të cilat një kopje dorëzohet pranë QKB-së, një kopje për palen blerëse dhe një kopje për palen shitëse.

PALA SHITËSE


BLEDAR SINANAJ

Bledar Sinanaj




PALA BLERËSE

ARSEN MUSAI

Arsen Musai


MENSUR RUSHITI

Mensur Rushiti
